



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-99

Prishtinë, më 6 prill 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 6 PRILL 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Nexhat Daci, Slllobodan Petroviq dhe Etem Arifi, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Xhezair Murati dhe Numan Baliq;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, këshilltar i kryetarit;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Selman Ymeri dhe Shefqet Rexhepi;

Nga Presidenca e Kosovës, Lumnije Murati;
Nga ICO: Blerta Bejtullahu;
Nga OSBE: Lejla Selimi, dhe
Nga NDI, Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe tri kërkesa shtesë, si vijon:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare dhe
3. Ratifikimi i plotësimit dhe ndryshimit të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Kryesia, me propozimin e kryetarit., miratoi

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 30 mars 2010,
2. Plotësimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare, që do të mbahet më 15 prill 2010, dhe
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 mars 2010

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 30 mars 2010, u miratua pa vërejtje.

Ramë Buja dhe Xhezair Murrati patën vërtetje në Transkript, që është korrigjuar.

2. Plotësimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare, që do të mbahet më 15 prill 2010

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që rendi i ditës për seancën e ardhshme të Kuvendit, që do të mbahet me **15 prill 2010**, të plotësohet edhe me këto pika:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për grevat,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë elektrike,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare,
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e Komisionit ad - hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, dhe
6. Propozimet e Grupit Parlamentar të LDK-së dhe të Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave:

3.1 Plotësimi i Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit, nr. 190, dt. 10.02.2010, për përbërjen e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, vendosi që Propozim-vendimi për plotësimin e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media t'i dërgohet seancës plenare, e cila do të mbahet më 15 prill 2010.

3.2 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Kornizën afatmesme të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2011 - 2013

Kryesia pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Propozim Korniza afatmesme të shpenzimeve të Kuvendit për periudhën kohore 2011 – 2013, i kthehet Komisionit për Buxhet dhe Financa, për shqyrtim.
2. Të hartohet një Projekt i përgjithshëm për investimet kapitale, përkatësisht për rinovimin e ndërtesës së Kuvendit në dy faza: a) rinovimi i përgjithshëm i aneksit të ri të ndërtesës dhe b) rinovimi i përgjithshëm i ndërtesës së vjetër.
3. Lidhur me projektin Vila “Gërmia”, ngarkohen sekretari i Kuvendit të Kosovës, sekretari i Zyrës së Presidentit, sekretari i Zyrës së Kryeministrit dhe sekretari i Ministrisë së Administratës Publike, që të shqyrtojnë mundësinë e përfundimit të tij si objekt i përbashkët protokollar i institucioneve të Republikës së Kosovës dhe propozimin e tyre t’ia paraqesin Kryesisë së Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme.

3.3 Njoftim i Grupit Parlamentar të LDK-së për emërimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, vendosi që e njëjta t'i dërgohet seancës plenare, e cila do të mbahet më 15 prill 2010.

3.4 Njoftim i Grupit Parlamentar të AAK-së për emërimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, vendosi që e njëjta t'i dërgohet seancës plenare, e cila do të mbahet më 15 prill 2010.

3.5 Ratifikimi i plotësimit dhe ndryshimit të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa ta shqyrtojë ndryshimin dhe plotësimin e Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në ora 12:10.

Hartoi: Divizioni për çështje plenare dhe procedurale